



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:074465

Datë: 20.05.2019

Numri i dokumentit: 00319879

P.nr.121/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurës A.A.. nga Gj..., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.136/18, të datës 30.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 15.05.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

E pandehura A... A... nga babai S... dhe nëna R..., e lindur K..., i lindur me datë .....në Gj..., ku edhe jeton në rrugën “Bajram Llovca” nr.8 me numër 98, ka të kryer shkollën e mesme , e martuar, e papunë, e gjendjes së varfër ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTORE

Sepse me datë 17.11.2018, në kohë të pa përcaktuar, në G...n, duke i fshehur faktet e me qëllim përfitimi të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten dhe për ti shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron të dëmtuarën A.. A... me vendqëndrim në L... të A..., në atë mënyrë që në viber në grup ku i kishte shoqet e shkollës ka postuar një raport mjekësor ku shkruhej se vajza e saj kishte nevojë për operim dhe më pas ka shkruar kush mundet me më ndihmu le të më ndihmoj edhe pse vajza e saj nuk ishte e sëmurë e as nevojë për operim dhe me të pa këtë postim dhe atë shkrim e dëmtuara e larte përmendur i ndanë 100 € nga të ardhurat e saj dhe ato ia dërgon përmes “.....” me ç’rast këtë të dëmtuar e ka dëmtuar për këtë shumë të parave të cilat e njëjta ia kishte dërguar duke menduar se vërtetë të njëjtës i nevojiteshin për operimin e vajzës,

-Me çka ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,46,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurës i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurës....., për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e pandehura në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet e pandehura që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 31.01.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.136/2018, kundër të pandehurës....., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPRK-së.

Më datë 15.05.2019, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja shtetit dhe e pandehura .....ndërsa mungoi e dëmtuara....., e cila ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës mirëpo gjykata nuk kishte dëshmi se e njejtja kishte pranuar ftesën. Në këtë seancë e pandehura pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores, e pandehura ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-së ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurës.

### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezent prokurorja e shtetit dhe e pandehura....., pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurës për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se e pandehura e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se e pandehura nuk ka qenë e detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbante aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehura A. A....., ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e pandehura në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se e pandehura ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se e njejta është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e saj dhe ka kërkuar falje për veprimet e saj, po ashtu gjykata mori parasysh faktin se e njejta ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurës ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurën është hera e parë që bie ndesh ligjin, po ashtu gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit sidomos atij me gjobë ka marrë parasysh edhe gjendjen financiare të të pandehurës, ku sipas shkresave të lëndës shihet se e njejta është e gjendjes së varfë ekonomike, asnjë nga anëtarët e familjes së saj të ngushtë nuk janë të punësuar dhe si rrjedhojë me çdo dënim tjetër mund të çenohej edhe mirëqenia e saj, fëmijëve dhe familjes së saj ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin se e pandehura me veprimet e saj ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme ka përfituar nga ana e të dëmtuarës .....andaj gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën....., e udhëzoi në kontest civil.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.121/19, me datë 15.05.2019

Procesmbajtësja,  
Donika Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2019:074465  
Datë: 20.05.2019  
Numri i dokumentit: 00319879